

GEMEENSCHAPSDIENST

(SHËRBIM KOMUNITAR)

Ju keni kryer një vepër penale. Për këtë duhet të paraqiteni para gjyqtarit për të miturit.

Ai mund t'ju vëri në dispozicion të zyrës sociale dhe të vendosi marrjen e disa masave të tjera. Një nga këto masa mund të jetë kryerja e një pune me efekt edukativ dhe në interesin e përgjithshëm. Emërtime të tjera që mund të keni dëgjuar rreth kësaj mase mund të jenë: shërbimi komunitar, puna e detyruar, dënimi alternativ, shërbimi social.

SI

- Ne organizojmë një bisedë të parë (zakonisht kjo bisedë bëhet si vizitë në shtëpi). Gjatë kësaj bisede ne do të kërkojmë së bashku me ju një vend të përshtatshëm pune.
- Ne do të shkojmë ta vizitojmë vendin e punës. Atje do flitet për disa kushte praktike dhe do të firmoset kontrata. Më pas, ju do të filloni punën.
- Ne do t'ju vizitojmë rregullisht në punë për të patur një ide të përkushtimit tuaj ndaj punës, sjelljes tuaj si dhe do të bisedojmë me ju rreth eksperiencës tuaj.
- Ne ju kërkojmë që ditën e fundit të punës ju të sillni me vete një letër drejtuar gjyqtarit për të miturit. Juve do t'ju jepen disa pyetje që do t'ju ndihmojnë ta shkruani këtë letër.
- Në fund të punës tuaj do bëhet dhe një bisedë vlerësimi në vendin e punës. Ne do shkruajmë një raport rreth kësaj bisede, i cili do t'i dërgohet gjyqtarit për të miturit, bashkë me letrën e shkruar nga ju.

SI PËRFUNDIM

Shërbimi komunitar përfundohet me sukses nëse ti...

- respekton datat e punës dhe orarin në mënyrë të përpiktë.
- respekton me përpikshmëri “rregulloren e brendshme” në vendin e punës.

Vertaling Nederlands-Albaanes.

Dit is de vertaling Albaanes van “Gemeenschapsdienst” en bevat identiek dezelfde informatie als de Nederlandse tekst. Deze vertaling mag enkel verspreid worden met de originele brontekst “Gemeenschapsdienst”.

- tregon përkushtim në punë dhe sillesh në mënyrë pozitive.
- tregon respekt ndaj punonjësve të tjerë dhe ndaj materialit në punë.
- mban përgjegjësi për këtë masë nga fillimi deri në fund (je disponibël, ke komunikim të sigurtë, vajtje-ardhje të rregullt në punë).
- shkruan një raport të sigurtë rreth eksperiencës tënde në këtë punë dhe këtë raport ja jep udhëzuesit tënd në ditën e fundit të punës.
- nuk kryen vepra të tjera penale.

INFORMACION I DOBISHËM

Punën do ta kryeni në një shërbim publik. Ky mund të jetë një shërbim i bashkisë, një shërbim provincial, një shërbim i OCMW-së (Qendra Publike për Mirëqënien Sociale) ose një Ojf (Organizatë jo-fitimprurëse). Këto shërbime kanë si qëllim të japin një kontribut shoqëror me anë të punës së tyre, kujdesit për banorët, dhe angazhimit ndaj shoqërisë. Duke u përkushtuar në punën tënde edhe ti do të japësh kontributin tënd për këtë. Ju nuk do të paguheni për kryerjen e kësaj pune.

Ju do e kryeni këtë punë gjatë kohës tuaj të lirë. Pas kryerjes së punës, gjyqtari për të miturit mund të vendosi ta mbylli dosjen tuaj ose t'ju vërë masa/kushte të reja.